URDHËR
Nr. 478, datë 28.8.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për ndjekjen e procedurave, për shqyrtimin dhe miratimin e shpërblimeve të sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, sipas rezultateve sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, z. Endrit Hoxha.
2. Kompetencat e deleguara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen deri në shfuqizimin e tij, si dhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi